



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.533/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada- Glllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Blerina Islami, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë vendit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur, më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 01.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli A.nr.533/2021, i datës 26.02.2021, i parashtruar nga Blerina Islami nga Gjermania, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë vendit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 26.02.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Blerina Islami të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 5 shkurt 2021, me të cilin thekson me datë 17.01.2021 i ka dërguar dokumentet e saj për regjistrim në KQZ, mirëpo nuk është përfshirë në listën e votuesve jashtë vendit.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, pasi që konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-së, me të cilën ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se në rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së, me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesi i apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- **a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;**

- **b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;**
- **c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;**
- **d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;**
- **e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe**
- **f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.**

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është e palejuar, nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.533/2021 më datën 01.03.2021

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.